RAPORTI VJETOR 2014

Përgatitur për

MBLEDHJEN E KUVENDIT TË STIKK



02 Prill, 2015

Ora 09:00 në ambientet e ICK

PËRMBAJTJA

Përmbajtja 2
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
Publikimet gjatë vitit 2014 6
Mbledhjet e bordit 6
Stafi i STIKK 6
Anëtarët e STIKK 6
Të hyrat dhe shpenzimet 6
Auditimi i financave të STIKK 6
AKTIVITETET 7
Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK 7
Objektivi 2: Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut 15
Objektivi 3: Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore 25
Objektivi 4: Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut 31
Objektivi 5: Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK 38
TË HYRAT DHE SHPENZIMET 40
Të hyrat 40
Shpenzimet 41
MBLEDHJET E BORDIT 42
Ndryshimet janë të listuara në vazhdim: 42
PËRMBYLLJE 47

STIKK
në 2014
114 anëtarë
42
17
48
7
Kompani (37%)
Profesionist në TIK (15%)
Student në TIK (42%)
Partner Akademik (6%)
12+
Projekte
giz
spark
ICK
BRITISH COUNCIL
NORWEGIAN MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS
138
persona të trajnuar
13
trajnime të organizuara

15+ konferenca/B2B
CeBIT
IT&BPO GERMANY
AUSTRIA
20+ Grupe Punuese/ Tryeza të Rrumbullakta
7 Publikime
ANALIZA E MANGËSISË SË SHKATHTËSIVE NË TIK
ANALIZA E TREGUT TË TIK NË KOSOVË
Çlirimi i Potencialit Eksportues të Kompanive Kosovare të TIK
Ekosistemi Funksional për Bizneset e Reja
MINISTRIA E INOVACIONIT & TEKNOLOGJISË
FEMRAT NË TEKNOLOGJI
South East Europe IT Industry Barometer (SEE ITIB) 2014 – Results for Kosovo
400000
300000
200000
100000
0
2400
42557
68239
132836
237106
368488
319007
2008
2009
2010
2011
2012
2013
2014
Qarkullimi Vjetor
2,365 Njerëz na pëlqejnë në
1,101 Njerëz na ndjekin në

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjate periudhës së njëvjeçare të 2014 janë realizuar aktivitete të cilat janë në përputhshmëri me objektivat e STIKK, si në vijim:

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK

Në saje të këtij objektivi, STIKK ka realizuar disa takime të rëndësishme, ku pjesëtarë të saj janë takuar me kryeministrin z. Hashim Thaçi, i cili vizitoi zyrën e STIKK në Prill, 2014; me z. Bujar Kelmendi, udhëheqës të sektorit për legjislacion dhe këshilla të Doganës së Kosovës; me z. Blerand Stavileci, Ministrin i Zhvillimit Ekonomik, etj. Gjithashtu stafi i STIKK mori pjesë në seminare dhe tryeza të ndryshme të cilat si cak kishin përmirësimin e gjendjes se qytetareve të Kosovës, ku kontributi i STIKK është vërejtur përmes këshillave dhe sugjerimeve. STIKK gjithashtu mori pjesë në vizitë studimore në Hungari në kuadër të projektit PROCON, i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet e internetit.

Faktor i rëndësishëm i suksesit të STIKK për vitin 2014 ishte qasja kreative në pika shumë të rëndësishme të cilat si pikë kryesore kishin përmirësimin dhe rritjen e mundësive për biznes-bërje në sektorin e TIK. Lirimi i pajisjeve të TIK nga taksat doganore, analiza e tregut të TIK në Kosovë, gjetja e mangësisë së shkathtësive në TIK, këto janë vetëm disa mënyra se si STIKK po e jep kontributin e lartshënuar.

Objektivi 2. Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

Përmes STIKK Training Academy janë organizuar në numër i konsiderueshëm i trajnimeve në temat: menaxhim i shitjes, marketing dhe promocion, menaxhim i marrëdhënieve me konsumatorë, "Kosovo Young Coders", në rrjete kompjuterike, bazat e TI, WomInnovation, e të tjera. Këto trajnime kanë ofruar njohuri në fusha të ndryshme për kategori të ndryshme të qytetareve, ku shpesh aktivitetet janë fokusuar në grupe të margjinalizuara, si për shembull femrat në TI dhe fëmijët.

Përveç këtyre, nuk mungoi edhe krijimi i hapësirave për shkëmbimin e përvojave dhe mundësive. Kjo ndodhi kryesisht përmes aktiviteteve si panairi i punës 2014 me emrin *"Karriera juaj në binarë"*, panairi i punës së Odës Ekonomike Amerikane, Business Tuesday,, e të tjera. Gjithashtu nuk mungoi vazhdimi i bashkëpunimeve, ku si shembull mund të marrim nënshkrimin e marrëveshjes me Këshillin Britanik rreth një sërë trajnimesh rreth Android, Social Media Management dhe Internet Marketing.

Objektivi 3. Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

Në sajë të këtij objektivi, STIKK ofroj anëtarëve pjesëmarrje në shumë aktiviteteve të ndryshme, ku mund të potencohen seance informuese për pjesëmarrje në HORIZON2020 me fokus në TIK, punëtoria e Open Government Partnership, punëtoria për zhvillimin e strategjisë për eksport të TI-së për Evropën Juglindore, në forumin "Gratë e Diasporës në Biznes", e të tjera. Në veçanti mund të konsiderohet pjesëmarrja e STIKK dhe anëtarëve të saj në CeBIT 2014 si një ndër sukseset të cilat tani janë bërë traditë.

Megjithatë rëndësisë së madhe të pikave të përmendura më parë, KosICT 2014 konferenca është ndër shtyllat kryesore të suksesit të STIKK dhe ICK për tërë vitin. Konferenca tre ditore ka rezultuar me takimin e 200 pjesëmarrës të cilët janë profesionistë të fushës së TIK dhe ku janë mbledhur për të diskutuar më të rejat e kësaj fushe.

Si aktivitet tjetër me rendësi ka qenë B2B ngjarja "Nearshoring Kosovo", aktivitet i cili është organizuar në bashkëpunim mes STIKK, ICK dhe Odës Ekonomike Austriake. Ne këtë ngjarje morën pjesë pesë kompani Austriake dhe kompani nga Kosova të cilat prezantuan veprimtarinë e tyre me qëllim të identifikimit të mundësive për krijimin e partneriteteve. Aktivitet i ngjashëm B2B për biznese i është ofruar edhe gjatë KosICT 2014 me kompani Gjermane dhe Norvegjeze.

Objektivi 4. Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

Në kuadër të këtij objektivi, në muajin korrik për herë të pestë u mbajt Dita mbarëkombëtare Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, në Prizren, e organizuar nga STIKK dhe AITA; GIZ dhuroi katër tabela (Pin Boards) në kuadër te një donacioni, me ç'rast udhëheqësja e ekipit të projekteve të GIZ për Kosovë, znj. Veronika Hofinger, përgëzoi STIKK-un për punën e saj të deritanishme; Mbulimi mediatik i projektit *"Young Coders Kosovo"* si dhe vizita e Kryetarit të Prishtinës, Shpend Ahmeti për Programeret e Rinj.

Gjithashtu, në muajin Prill u mbajt Kuvendi i gjashtë i radhës i Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) me ç'rast edhe u prezantua puna njëvjeçare e Shoqatës nga znj. Çavolli, u aprovuan ndryshimet në Statut dhe u përzgjodhën anëtarët e rinj e Bordit të STIKK; pjesëmarrja në tryezën e rrumbullaket me temën *"Përdorimi i mediave sociale në komunikimin komunë – qytetarë"*; pjesëmarrja në konsultimin publik dhe prezantimin e programit IPA II - bashkëpunimi ndërkufitar 2014-2020 Kosovë-Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë; si dhe u organizuan dy punëtoritë e fundit për draftimin e Strategjisë Nacionale te TI-së.

STIKK, për të ofruar profesionalizëm maksimal, ka deleguar pjesëtar të stafit për të marrë pjesë në trajnime dhe aktivitete të ndryshme. Ndër këto aktivitete janë trajnime rreth avokimit, lobimit dhe shkrimit të projekt propozimeve, një punëtori rreth strategjisë për eksport të TIK në Sarajevë të Bosnjës dhe Hercegovinës, dhe aktivitete argëtuese, si Festa e Fundvitit, traditë e STIKK dhe ICK të mbajtur me 19 Dhjetor. Një çështje që vlen të përmendet është se STIKK ka ofruar prezantim për minoritete Serb, ku është promovuar përfshirja e tyre në industrinë e TIK para studenteve dhe profesionalisteve.

Objektivi 5. Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

Duke konsideruar aspektin social të rëndësishëm, STIKK ka ofruar kontributin në disa mënyra. Në Prill u organizua dita e dhurimit të gjakut, ndërsa përveç stafit të STIKK, ICK dhe Athene, prezent ishin edhe disa kompani anëtare. Në Shtator vazhdoj tradita e dhurimit të gjakut, ndërsa përveç stafit te STIKK, ICK dhe Athene Kosovo, ishin edhe ekipet e inkubatorit të ICK-së, përfaqësues te kompanive anëtare te STIKK si dhe njerëz të tjerë që nuk janë pjesë e qendrës.

Përveç prezantimeve për nxënësit të shkollës "Mileniumi 3" rreth inovacionit, STIKK gjithashtu kontribuoi në hartimin e draft-strategjisë kombëtare për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet.

Publikimet gjatë vitit 2014

- Studimi i "IT Barometer Kosovo" http://stikk-ks.org/uploads/downloads/IT_Barometer_Kosovo.pdf
- Analiza e Mangësisë së Shkathtësive në TIK http://stikk-ks.org/uploads/downloads/STIKK_skills_gap.pdf
- Analiza e Tregut të TIK në Kosovë http://stikk-ks.org/uploads/downloads/STIKK_market_analysis_01.pdf
- Femrat në Teknologji http://stikk-ks.org/uploads/downloads/Femrat_ne_Teknologji_-_Sfidat_e_femrave_ne_TIK.pdf
- Ekosistemi Funksional për Bizneset e Reja http://stikk-ks.org/uploads/downloads/Enabling_Startup_Ecosystem__alb_.pdf
- Çlirimi i Potencialit Eksportues të Kompanive Kosovare të TIK http://stikk-ks.org/uploads/downloads/Unleashing_the_export_potential__alb__01.pdf
- Ministria e Inovacionit dhe Teknologjisë http://stikk-ks.org/uploads/downloads/Ministry_of_Tech_and_Innovation__Alb_.pdf

Mbledhjet e bordit

Gjatë vitit 2014 u mbajtën gjithsej gjashtë mbledhje të Bordit të STIKK, katër të rregullta (7 Shkurt, 14 Maj, 24 Korrik dhe 11 Nëntor) dhe dy të jashtëzakonshme (24 Janar dhe 8 Prill).

Stafi i STIKK

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2014, janë bërë disa ndryshime në stafin e STIKK:
Në cilësinë e praktikantit, gjatë vitit 2014 praktiken e kanë përfunduar Lorik Mullaademi *(10.03.2014-09.06.2014)*, Marigona Gorqaj *(07.07.2014-06.10.2014)*, Besa Gjonbalaj *(21.07.2014-20.10.2014)* dhe Leonora Hajdari *(01.10.2014-31.12.2014)*. Gjatë kësaj kohe gjithashtu janë punësuar Doruntina Sadiku *(Asistente e Projektit, prej 10.02.2014)*, Lorik Mullaademi *(Asistent i Projektit, prej 10.06.2014)* dhe Marigona Gorqaj *(Asistente Financiare, prej 07.10.2014)*. STIKK kishte 11 punëtorë me orar të plotë dhe 4 praktikant. Në anën tjetër z. Valon Canhasi është larguar me 1 korrik 2014 dhe më nuk është pjesë e stafit të STIKK. Gjatë implementimit të aktiviteteve, STIKK ka angazhuar 17 konsulent të ndryshëm dhe ka krijuar obligime subkontraktuese me 27 palë.

Anëtarët e STIKK

Me 2014, janë anëtarësuar 6 Kompani te reja: Rikon, Epaytech, Eltring shpk, Trigonomi, Meduza dhe Ameble, duke e rritur kështu numrin e anëtarëve ne 42. Pas revidimeve te kompanive anëtare, tani STIKK numëron 114 anëtarë (42 kompani, 17 profesionist, 48 studente dhe 7 institucione arsimore). Gjate vitit 2014, anëtarësinë e kane paguar gjithsej 42 kompani anëtarë ose 36.84% nga numri i gjithmbarshëm, 17 anëtarë profesionist ose 14.91% dhe 48 studente ose 42.10%.

Të hyrat dhe shpenzimet

Gjatë vitit 2014, të hyrat e STIKK ishin 319,007€ (15.51% më pak krahasuar me 368,488€ të vitit 2013), ndërsa shpenzimet kapin shumën prej 325,881€ (4.21% më pak krahasuar me 339,595€ në vitin 2013).

Auditimi i financave të STIKK

Kompania audituese e pavarur “Balluku & Zhaveli”, e përzgjedhur nga anëtarët e STIKK ne Mbledhjen e Kuvendit 2014, do të bëjë auditimin e të gjitha transaksioneve dhe procedurave financiare të STIKK për periudhën 1 Janar-31 Dhjetor 2014. Ky auditim do te realizohet gjatë muajit shkurt, ndërsa raporti do te prezantohet ne Mbledhjen e Kuvendit 2015.

AKTIVITETET

Objektivi 1. Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për mbështetjen e rritjes së përshpejtuar të sektorit të TIK

16 Janar 2014

LIROHEN PAJISJET E TIK NGA TAKSAT DOGANORE

Në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës është publikuar Ligji Nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor. STIKK në bashkëpunim me anëtarët e saj, me qëllim të krijimit të një mjedisi të favorshëm legjislativ dhe politik për zhvillimin e përshpejtuar të sektorit të TIK, është angazhuar që nga fillimi i inicimit të këtij projektligji duke organizuar grupe punuese në mes të anëtarëve të saj dhe të palëve të interesit. Pas shumë peripecive dhe vonesave burokratike, ky projekt ligj më në fund u miratua në Kuvendin e Kosovës në seancën e dhjetorit të vitit 2013.

Ky ligj do të ketë ndikim në zhvillimin e të gjithë sektorëve si dhe në vetë shoqërinë e Kosovës, duke ulur koston e pronësisë se këtyre pajisjeve. Ne si STIKK do të vazhdojmë te avokojmë për lehtësira në taksa duke zbritur TVSH-në nga 16% në 5% në pajisjet e TIK.

Vegëza: http://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8987

11 Shkurt 2014

STIKK PREZANTON GJETJET E HULUMTIMEVE NË SEKTORIN E TIK

STIKK dhe projekti EYE kanë prezantuar raportet: Analiza e Mungesës së Shkathtësive në TIK, dhe Analiza e Tregut të TIK në Kosovë. Këto raporte janë përpiluar pas hulumtimit të realizuar me rreth 500 kompani në Kosovë me qëllim të identifikimit të potencialit të rritjes dhe zhvillimit të sektorit TIK. Me këtë rast në ngjarje ishin prezent mbi 50 pjesëmarrës, ekspert nga fusha e TIK të cilët morën pjesë në diskutimin mbi të gjeturat e hulumtimit.

Vegëza: http://www.stikk-ks.org/uploads/downloads/STIKK_Analiza_E_Tregut_TIK.pdf
http://www.stikk-ks.org/uploads/downloads/Analiza_e_mangesise_se_shkathtesive_ne_TIK_.pdf

11 Prill 2014

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI VIZITOI STIKK

Më 11 Prill 2014, kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaçi vizitoi STIKK dhe ICK, ku gjatë kësaj vizite kryeministri pati rastin të njoftohet më shumë për të arriturat e STIKK, zhvillimet në TIK, si dhe të mësoj më shumë për brengat dhe pengesat e sektorit TIK. Në takim ishin te pranishëm anëtaret e bordit z. Shkumbin Brestovci , z. Driton Hapciu, z. Enver Doko si the drejtoresha ekzekutive Vjollca Çavolli.

Gjate takimit, Kryeministrit iu prezantua dokumenti me ane te cilit u kërkuan këto pika:

- Të përcaktohet sektori i TIK, si sektor prioritar në kuadër të strategjisë zhvillimore të Kosovës;
- Krijimin e ministrisë së TIK dhe Inovacionit në mandatin e ardhshëm qeveritar;
- Heqjen e taksave për kompanitë e orientuara në eksport te shërbimeve;
- Zvogëlimi i TVSH-së për pajisjet e TIK nga 16% në 5%;
- Zgjerimi i listës për pajisjet e TIK të liruara nga taksa doganore;
- Rritja e financimeve publike për inovacionet dhe kërkim-zhvillim në sektorin e TIK;
- Përkrahjen e ndërmarrësisë dhe "StartUp"-ve ne sektorin TIK;
- Nënshkrimi i një marrëveshjeje për partneritet strategjik në mes të Qeverisë dhe STIKK me qëllim të zhvillimit të mëtutjeshëm të sektorit.

Kryeministri i Kosovës u pajtua me faktin që Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit duhet të jetë sektor prioritar për zhvillimin e vendit, ku Kosovaret do të kenë mundësi të bëhen një shtet që ka për bazë dijeninë për zhvillimin e ekonomisë. Gjithashtu, Kryeministri u dakordua qe të na përkrah në krijimin e ministrisë së inovacionit dhe TIK, rritjen e financimit për TIK, përkrahjen e inovacionit dhe StartUps, si dhe nënshkrimin e një marrëveshjeje midis Qeverisë dhe STIKK-ut.

11 Prill 2014

STIKK MORI PJESË NË PUNËTORINË E PROJEKTIT TRIPLE HELIX

Me datën 11 Prill 2014, STIKK morri pjesë në punëtorinë e organizuar nga grupi i OECD me përkrahje të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Komisionit Evropian, me emrin "Triple Helix Project" në ambientet e kolegjit Universum, ku morën pjesë delegatë nga institucione vendore, shoqëria civile dhe akademia.

Në këtë punëtori u bisedua më gjerësisht për rolin e OECD në implementimin e projektit Triple Helix, arritjet e ngjashme në vendet tjera të Ballkanit sikurse Bosnja dhe Kroacia, ngritjen e kapaciteteve për inovacion, dhe lidhjen midis trekëndëshit Qeveri-Universitet-Industri.

Vegëza: http://stikk-ks.org/artikulli/article/news/view/stikk-mori-pjese-ne-triple-helix-project-workshop/

23 Prill 2014

STIKK TAKOHET ME DOGANAT E KOSOVËS

Bazuar në kërkesën e anëtarëve te STIKK me datën 23.04.2014, organizoi takimin me z. Bujar Kelmendi, udhëheqës i sektorit për legjislacion dhe këshilla ku morën pjesë drejtoresha ekzekutive e STIKK znj. Vjollca Çavolli së bashku me përfaqësuesit e disa kompanive anëtare si Asseco, Cacttus, Art House, ITD Kosova, Ilir Kosova.

Qëllimi i takimit ishte diskutimi i problemeve administrative të importit të pajisjeve të TIK të cilat janë të liruara me ligj nga tatimi doganor, si dhe problemeve me të cilat janë duke u ballafaquar kompanitë e sektorit te TIK.

STIKK së bashku me kompanitë pjesëmarrëse si dhe me përkrahjen e doganave te Kosovës, u dakorduan që të punohet një manual interpretues mbi Ligjin Nr. 04/L-163 për mallrat e liruara nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor, me qëllim të lehtësimit të implementimit të ligjit në mënyrë adekuate. z. Kelmendi, shprehi gatishmëri e tij për të ndihmuar kompanitë dhe njëkohësisht u dakordua që pasi të punohet dokumenti të organizohet një takim me përfaqësuesit e doganave.

3 Qershor 2014

STIKK MORI PJESË NË TRYEZAT E PËRFAQËSIMIT TË SHOQATAVE KARSHI PARTIVE POLITIKE

Me datat 27 Maj dhe 3 Qershor, STIKK mori pjesë në Tryezat e Përfaqësimit të Shoqatave karshi Partive Politike, për të i shprehur shqetësimet si dhe nevojat qe duhet te adresohen gjatë mandatit të ardhshëm qeverisës. Kjo ngjarje u organizua nga D4D dhe kishte për qëllim informimin dhe inspirimin e partive politike për të i përfaqësuar çështjet specifike. Partitë politike kanë prezantuar programet e tyre në mënyrë që ato të sfidohen nga përfaqësuesit e shoqatave. Reagime pozitive ka pas gjatë diskutimit nga të gjitha partitë politike, duke argumentuar rolin e shoqërisë civile në politikë-bërje.

Gjatë takimit, STIKK shpalosi nevojën për një Ministri të TIK dhe Inovacionit, si dhe adresoi çështjet e taksave në TIK, të cilat janë më të pafavorshmet në rajon.

Vegëza: http://stikk-ks.org/artikulli/article/news/view/stikk-mori-pjese-ne-tryezat-e-perfaqesimit-te-shoqatave-karshi-partive-politike/

23-28 Qershor 2014

STIKK MERR PJESË NË VIZITËN STUDIMORE NË HUNGARI

Me 23-28 Qershor, STIKK mori pjesë në vizitë studimore në Hungari, në kuadër të projektit PROCON, i cili ka për qëllim mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet e internetit. Vizita u organizua nga KEC (Kosovo Education Center), ndërsa pjesëmarrës ishin përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; ARKEP-it, ISP-ve (IPKO, PTK dhe Kujtesa), si dhe KYC (Kosovar Youth Council). Në kuadër të vizitës, u realizua edhe takimi me Ambasadorin e Kosovës në Hungari, Z. Sami Ukelli.

16 Shtator 2014

STIKK MORI PJESË NË SEMINARIN RRETH KORNIZËS KOMBËTARE TË KUALIFIKIMEVE

Me datën 16 Shtator, STIKK mori pjesë në seminarin rreth Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve-mbi llojet e kualifikimeve për palët e interesit nga Arsimi i Përgjithshëm dhe AAP.

Qëllimet e këtij seminari ishin:

- të sigurohet që pjesëmarrësit të kuptojnë arsyeshmërinë e llojeve të kualifikimit në KKK;
- të identifikohen çështjet të cilat ndikojnë në komunikimin me përdoruesit rreth kualifikimeve në arsimin e përgjithshëm dhe AAP;
- të mblidhen udhëzime nga pjesëmarrësit mbi natyrën dhe përdorimin e llojeve të kualifikimit.

Në prezantimin e parë u bisedua më shumë për llojet e kualifikimit në KKK, ku u dhanë disa shembuj duke përfshirë Zelandën e Re, Irlandën dhe Skocinë. Çështja kryesore e diskutimit ishte se cili nga këta shembuj do ishte i dobishëm për Kosovën. Këto çështje u prezantuan nga John Hart një ekspert ndërkombëtar.

Gjithashtu në dy punëtoritë e organizuara gjatë kësaj dite pjesëmarrësit patën rastin të adresojnë pyetje lidhur me arsyeshmërinë dhe bazat për llojet e kualifikimit në KKK të Kosovës.

30 Shtator 2014

STIKK MERR PJESË NË TAKIMIN PËR HARTIM TË STRATEGJISË PËR ORIENTIMIN DHE KËSHILLIMIN NË KARRIERË

Me datën 30 Shtator, STIKK mori pjesë në takimin informativ i cili u mbajt në Ministrinë e Arsimit e Shkencës dhe të Teknologjisë. Qëllimi i këtij takimi ishte hartimi i një strategjie për orientim dhe këshillim në karrierë. Në këtë takim u diskutua rreth punës dhe metodologjisë së procesit e hartimit të strategjisë. Zhvillimi i kësaj strategjie ka për synim që orientimi në karrierë të integrohet në sistemin arsimor.

STIKK vazhdimisht ka realizuar hulumtime të shumta, si dhe pasur iniciativa dhe projekte përmes të cilave ka ndihmuar studentët të kenë qasje në me këshilla si dhe informata rreth të orientimit në karrierën e duhur. STIKK do vazhdojë angazhimin e saj në këtë drejtim si dhe do të jetë pjesë e grupeve që do të marrin pjesë në këto seminare të organizuara MASHT, të cilat planifikohen të zgjasin deri në dhjetor.

27 Qershor 2014

PUNËTORIA PËR ZHVILLIMIN E STRATEGJISË PËR EKSPORT TË TI-SË PËR EVROPËN JUGLINDORE

Me 26-27 Qershor u mbajt punëtoria e radhës për zhvillimin e strategjisë rajonale të eksportit të shërbimeve të TIK në Budvë, Mal i Zi. Në këtë punëtori u diskutuan masat që duhet të merren për ta rritur eksportin si rajon si dhe planifikimi i planit operacional duke përfshirë edhe planifikimin e aktiviteteve.

Gjate kësaj punëtorie u diskutua edhe vizita studimore që do të bëhet me 6-10 Tetor, 2014 në Vjenë, Austri dhe në Munih, Gjermani. Në këtë vizitë do të marrin pjesë të gjitha shoqatat e rajonit të përfshira në zhvillim të kësaj strategjisë. Çdo shoqatë do të përfaqësohet nga 3 pjesëmarrës, 1 person ekzekutiv i shoqatës që ka qenë i angazhuar në punëtoritë e mëparshme dhe 2 anëtarë të bordit kompanitë e të cilëve eksportojnë shërbime në shtetet gjermano-folëse dhe që kanë referenca nga këto shtete. Qëllimi i kësaj vizite është të promovohet rajoni si rajon potencial dhe të promovohet sektori i TIK i Kosovës.

21 Nëntor 2014

PUNËTORIA E FUNDIT PËR ZHVILLIMIN E STRATEGJISË TË EJL (EVROPA JUGLINDORE) PËR EKSPORT TË SHERBIMEVE TË TIK

Si pjesë e projektit për të zhvilluar Strategjinë EJL për eksport të TIK, përkrahur nga projekti ORF nga GIZ, STIKK mori pjesë në një punëtori përmbyllëse e cila u mbajt në Sarajevë me 19-20 Nëntor 2014. Gjatë kësaj punëtorie grupi punues arriti të identifikojë dhe të radhitë të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me promovimin e regjionit EJL si IT Outsourcing destination. Zbatimi i të gjitha këtyre aktiviteteve planifikohet të fillojnë gjatë çerekut të parë të vitit 2015.

23 Nëntor 2014

STIKK MORI PJESË NË PUNËTORINË PËR HARTIMIN E DRAFT-STRATEGJISË KOMBËTARE PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA RREZIQET NË INTERNET

Me datën 20 Nëntor deri më 23 Nëntor 2014, STIKK mori pjesë në punëtorinë për hartimin e draft-Strategjisë Kombëtare për *"Mbrojtjen e Fëmijëve nga Rreziqet në Internet"*, e iniciuar nga Projekti evropian PROCON, që organizohet nga Kosovo Education Center (KEC) në partneritet me Kosovar Youth Council (KYC). Gjatë kësaj punëtorie, u punua në analizimin e gjendjes dhe zhvillimin e objektivave që do të përpunohet pastaj më tutje në një draft strategji e cila do të prezantohet para palëve të interesit në punëtorinë e ardhshme.

27 Nëntor 2014

UDHËTIM PËR DELEGATË NGA QEVERIA, BIZNESI DHE AKADEMIA NGA KOSOVA DHE SHQIPËRIA

OECD organizoi një udhëtim studimor në Lubjanë dhe Trieste, me 24-27 nëntor 2014 për kontekstin e Triple Helix në Shqipëri dhe Kosovë, të cilat janë të implementuara nën Shtyllën e Asistencës Teknike të Ballkanit Perëndimor për Zhvillimin e Ndërmarrjeve dhe Investimeve Kornizë (EDIF), e mbështetur nga Komisioni Evropian (KE).

Studim filloi të martën (25 Nëntor), me një takim në Institutin Jozef Stefan (JSI) me znj. Marjeta Trobec dhe Z. Luka Virag. Znj. Trobec dha një pasqyrë të historisë së Institutit të Stefan Jozef, nga instituti shkencor kërkimor në Slloveni. Znj. Lea Kane, Menaxhere e Komunikimeve në JSI, prezantoi projektet e BE-së me të cilin Instituti është i implikuar dhe ngjarjet e rrjeteve që ndihmojnë shkencëtaret e rinj të jenë të përfshirë në JSI.

Në ditën e dytë delegacioni udhëtoi për në Trieste për të vizituar Parkun e Shkencës "AREA" dhe të takohet me Znj. Laura Ramacci dhe Z. Alessandro Deltreppo. Znj Ramacci dha një pasqyrë të parkut, i cili përfshin 3 kampuset, 94 qendrat kërkimore dhe kompanitë e teknologjisë së lartë, 2,500 të punësuar dhe 190 milion euro në të ardhura. Në ditën e fundit, delegacioni u takua me Z. Istak Lesnak dhe Znj. Marjana Majeric të Parkut Teknologjik të Lubjanës. Z. Lesnak, Menaxheri i Përgjithshëm, dha një pasqyrë të infrastrukturës hi-tech dhe të shërbimeve që parku ofron kompanive të saj anëtare 280. Ai vuri në dukje rëndësinë e të paturit një universitetit të kualitetit të lartë në Lubjanë, e cila zhvillon aftësitë dhe idetë që ushqejnë parkun e teknologjisë.

24 Dhjetor 2014

VIZITA E MINISTRITË TË MZHE-SË, Z. BLERAND STAVILECI

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, zotëri Blerand Stavileci, vizitoj STIKK dhe ICK për të mësuar më shumë për komunitetin e TIK dhe inovacionit në Kosovë, si dhe për të identifikuar mundësitë e bashkëpunimit dhe mënyrat e asistencës nga Qeveria për këtë sektor.

ICK dhe STIKK i prezantuan ministrit punën e bërë në tri vitet e fundit, strategjinë nacionale të zhvillimit të sektorit, planet për hapjen e qendrave të reja për inkubim të StartUp bizneseve, propozimet për ndryshime në paketën fiskale si dhe shembuj të modeleve të suksesshme të funksionimit të qendrave inovative në rajon dhe botë.

Objektivi 2: Zhvillimi i burimeve njerëzore në pajtueshmëri me nevojat e sektorit të TIK-ut

14 Janar 2014

BUSINESS TUESDAY #13

Ekspertë dhe persona drejtues në fushën e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në Kosovë diskutuan mbi trendët teknologjike në Kosovë dhe botë për vitin 2014 para mbi 60 të pranishmëve në ICK. Znj. Vjollca Çavolli drejtoreshë ekzekutive e Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) preku temat si promovimi i Kosovës si një vend ku TI ka potencial të madh, dhe se si për të rinjtë e Kosovës teknologjia nuk është vetëm pjesë e përditshmërisë si mjet i komunikimit, por gjithnjë e më shumë edhe mjet i punës.

21 shkurt 2014

MARRËVESHJA ME BRITISH COUNCIL PËR TRAJNIME

Me 21 shkurt, u nënshkrua një marrëveshje në mes te STIKK dhe British Council për organizimin e tri trajnimeve në fushën e TIK: Android, Social Media Management dhe Internet Marketing. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje është deri me 30 qershor.

28 Shkurt 2014

ICT-KOSEU: TRAJNIM I TRAJNERËVE PËR PJESËMARRJE NË KORNIZËN E RE TË KE: HORIZON2020

STIKK, si partnere e projektit ICT-KOSEU, organizoi seancën trajnuese për 13 pjesëmarrës nga akademia, sektori i biznesit dhe qeveria në ambientet e ICK-së. Ligjërues ishte z. Ulrich Boes (URSIT, Bullgaria, partner i projektit ICT-KOSEU) i cili ndau me pjesëmarrësit përvojat e tij në projektet e KE, prezantoi rregullat e reja, dhe ofroi praktikat e mira të zbatimit të projekteve të KE. Në seancën e pasdrekes pjesëmarrësit patën rastin të dëgjojnë Dr. Venet Osmani (udhëheqës i grupit dhe hulumtues në CREATE NET, Trento, dhe zëvendës ligjërues në Universitetin e Trento's, Itali) dhe Uni-Prof. Dr. Wolfgang Slany, lidhur me përvojat e drejtpërdrejta në projektet hulumtuese.

Ligjërues: Ulrich Boes, Dr. Venet Osmani, Dr. Wolfgang Slany

21 Mars 2014

STIKK TRAINING ACADEMY ORGANIZOI TRAJNIM PËR 15 FEMRA NË KUADËR TË PROJEKTIT "WOMINNOVATION"

Trajnimi u organizua në kuadër të projektit "WomInnovation" dhe ishte i dedikuar në mësimin e gjuhës programuese "JavaScript". Trajnimi është zhvilluar në ambientet e ICK-së. Në këtë trajnim morën pjese dhe u certifikuan 15 femra studente.

Ligjërues: Driton Haxhiu

Donatorë: wominnovation

22 Mars 2014

STIKK PËR HERË TË DYTË PËRKRAHË ORGANIZIMIN E ALSSUG

Në hapësirat e ICK u organizua takimi i tretë me radhë për ALSSUG, ku në këtë ngjarje ligjëruesit patën rastin të zhvillojnë ligjërime teknike me përvojë nga fusha të ndryshme për Database Administration dhe Database Development. Në takim diskutuan Dukagjin Maloku (SQL Server MVP/DBA ALSSUG), Florim Maxhuni (Programer në Raiffeisen Bank Kosovo), Lamir Shkurti (Zhvillues i Databazave), si dhe Donika Bajrami (Zhvilluese e Softuerit dhe trajnere për SQL Server në Cacttus).

Ligjërues: Dukagjin Maloku, Florim Maxhuni, Lamir Shkurti, Donika Bajrami

27 Mars 2014

STIKK MORI PJESË NË SEMINARIN E AEP NË TIRANË, SHQIPËRI

Shkëmbimi Akademik për Progres (AEP) lehtëson shkëmbimin akademik dhe ndërtimin e kapaciteteve brenda një shteti, i cili do bëhet në bashkëpunim ndërmjet institucioneve partnere në Norvegji, Maqedoni, Shqipëri dhe Kosovë. Objektivat kryesore të këtij programi është rritja e kapaciteteve të fakulteteve të TIK në vendet e sipër-përmendura, shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Në këtë seminar, drejtoresha ekzekutive e STIKK, znj. Vjollca Çavolli, ishte moderatore e seancës së panelit për temën *"Si të adresohen mangësitë e shkathtësive dhe të përmirësohet bashkëpunimi në mes të kompanive dhe universiteteve? Përvojat, mundësitë dhe sfidat që lidhen me bashkëpunimin në mes të kompanive dhe universiteteve".* Pjesëmarrës në këtë seancë ishin Adrian Besimi nga SEEU, Maqedoni, Edmond Hajrizi nga UBT, Kosovë, Dritan Mezini nga AITA, Shqipëri, Darko Asov nga Crimson Maqedoni si dhe kompani nga Norvegjia dhe Ballkani.

28 Mars 2014

STIKK TRAINING ACADEMY ORGANIZOI TRAJNIM NË IT FUNDAMENTALS

Në këtë trajnim studentët patën rastin të zhvillojnë njohuri pune se si funksionojnë kompjuterët, punë praktike në montimin e kompjuterëve, dhe si të zgjidhen çështjet e harduer dhe softuer. Pas nënshtrimit në test, 14 pjesëmarrësit u certifikuan me një certifikatë të pjesëmarrjes.

Ligjërues: Veton Xhelili

Donatorë: spark ignites ambition

4 Prill 2014

STIKK TRAINING ACADEMY ORGANIZOI TRAJNIM NË NETWORK TRAINING

Trajnim pesëditor i 18 studentëve të cilët patën rastin të zhvillojnë njohuri më të thellë për rrjete, Ethernet, IP adresa, shtrirjen dhe implementimin e rrjetave, si dhe protokollet dhe komunikimet e rrjetave.

Ligjërues: Gzim Vatovci

Donatorë: spark ignites ambition

16 Prill 2014

TRAJNIMI I SHOQATAVE MBI CIKLIN E POLITIK-BËRJES

Më 16 prill 2014 Instituti D4D ka organizuar trajnimin e parë për shoqatat mbi ciklin e procesit të politik-bërjes për ligjvënie dhe qeverisje sa më të mirë dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë. Me përfshirjen e shoqatave në proceset vendimmarrëse, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare do të kenë më të lehtë përpilimin dhe zbatimin e politikave publike. Temat kryesore të trajnimit kanë përfshirë qasjen e shoqatave në identifikimin e problemeve, vlerësimin e qëndrimeve politike, dhe mënyrat se si shoqatat duhet të ndikojnë në proceset e politik-bërjes.

Trajnimi u zbatua në formë interaktive duke inkurajuar pjesëmarrjen aktive të të gjithë shoqatave në mënyrë që praktikat më të mira të shkëmbehen gjatë ushtrimeve të planifikuara. Si rezultat i këtij trajnimi ishte krijimi i një udhërrëfyesi të shkurtë me metodat më të përsosura që shoqatat të ndikojnë më shumë në politikë. STIKK morri pjesë ne këtë takim duke shkëmbyer përvojën ne politik-bërje.

Vegëza: http://stikk-ks.org/artikulli/article/news/view/trajnimi-i-shoqatave-mbi-ciklin-e-politik-berjes/

28 Prill 2014

EDICIONI I NJËMBËDHJETË I PANAIRIT TE PUNËS I ODËS AMERIKANE

Për të njëmbëdhjetën herë me radhë, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë, kësaj here në bashkëpunim me kompaninë The HeadHunter organizuan Panairin e Punës. Ngjarje kjo tashmë tradicionale e cila sjell së bashku punëkërkuesit dhe kompanitë më serioze kosovare nga sektorë të ndryshëm, si banka dhe financa, kontabilitet dhe auditim, ndërtimtari dhe farmaceutikë, prodhim ushqimi, tregti, konsulencë afariste, marketing dhe marrëdhënie me publikun.

Përfaqësues nga Shoqata e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (STIKK) gjatë punëtorisë prezantuan Analizën e Mangësisë së Shkathtësive ndërsa akterë të ndryshëm relevantë patën mundësinë që të diskutojnë lidhur me përpjekjet të cilat po bëhen ashtu që fuqia punëtore në Kosovë të mund të plotësojë nevojat e kërkesës së tregut të punës.

Vegëza: http://stikk-ks.org/artikulli/article/news/view/mbahet-edicioni-i-njembedhjete-i-panairit-te-punes-i-odes-amerikane-1/

30 Prill 2014

KOSOVO YOUNG CODERS

Në Prill të këtij viti, STIKK filloi pilot-projektin e quajtur Kosovo Young Coders. Qëllimi i këtij projekti është trajnimi i fëmijëve të moshave të hershme në TIK në mënyrë që të pajisen me njohuri në fazë sa me të hershme.

Ekipi i STIKK ka identifikuar 11 fëmijë te moshës 9-14 vjeçare të cilët gjatë kësaj periudhe kanë mësuar gjuhë programuese. STIKK gjithashtu ka identifikuar trajnerin për këta fëmijë, dhe ka angazhuar 5 studente femra të FIEK të cilat kanë vepruar si asistente. Të gjitha aktivitetet në kuadër të këtij pilot-projekti janë bërë në baza vullnetare. Pritet që këta fëmijë të garojnë online nga Kosova në garën e cila zhvillohet në Plymouth, Angli gjatë javës së parë të Gushtit.

27 Maj 2014

PANAIRI I PUNËS 2014 – "KARRIERA JUAJ NË BINARË"

STIKK në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë anëtare si dhe me asistencën e bashkëpunëtorëve akademik organizoi *"STIKK Panairin e Punës 2014"* për sektorin e TIK, ku qëllim kryesor i këtij panairi ishte ulja e shkallës së papunësisë si dhe ofrimi i mundësisë së studentëve/profesionistëve për të u njoftuar me sektorin privat dhe kërkesat e tyre si punëdhënës.

Panairi i Punës u mbajt me 27 Maj 2014, në Innovation Centre Kosovo (ICK), në Prishtinë. Pjesëmarrëse në Panair ishin 11 kompani të profilit të TIK (Trokit, SAP, AdaptivIT, Asseco, Cacttus, DataPrognet, ITD, Sollaborate, ZagApps, DM Consulting dhe Entermedia). Secila nga këto kompani patën rastin të promovojnë kompanitë, produktet/shërbimet e tyre, gjithashtu në këtë panair kishte 40 vende të hapura pune. 560 vizitor e vizituan këtë panair të cilët njëkohësisht aplikuan në pozitat e ofruara nga kompanitë. Bazuar ne përshtypjet e kompanive pjesëmarrëse, secila nga kompanitë kontaktuan përafërsisht nga 120 studentë/profesionistë në këtë panair. Për më tepër kompanitë dhe pjesëmarrësit e panairit u ndan të kënaqur me organizimin e panairit, posaçërisht me lokacionin dhe kohën në të cilën u mbajt ky event.

STIKK planifikon të organizojë ne vazhdimësi Panaire Pune të tjera për sektorin e TIK.

30 Maj 2014

TRAJNIMI 5 DITOR NË DATABAZË

STIKK Training Academy duke filluar prej datës 26-30 Maj, 2014 organizoi trajnimin 5 ditor në Databazë. Ky trajnim i ishte dedikuar të gjithë studentëve të TIK dhe anëtarëve të STIKK-ut. Në këtë trajnim pjesëmarrësit kanë pasur rastin të:

- Mësojnë si te instalojnë dhe konfigurojnë te dhënat, si të i administrojnë ato, si të ruajnë dhe te sigurojnë te dhënat dhe si eksportohen apo importohen të dhënat brenda kompanisë;
- Në fund të trajnimit pjesëmarrësit kanë aplikuar të gjitha metodat e mësuara në praktike që të shohin se si realisht funksionojnë të gjitha konceptet e sqaruara;
- Për këtë trajnim, të gjithë pjesëmarrësit ditën e fundit pranuan një certifikatë të pjesëmarrjes.

6 Qershor 2014

TRAJNIMI MBI MENAXHIMIN E MARRËDHËNIEVE ME KONSUMATORË (CRM)

Në kuadër të STIKK Training Academy nga data 2 – 6 Qershor u mbajt trajnimi Menaxhimi i Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM) ligjëruar nga z. Dario Car, i cili iu dedikua të gjitha kompanive anëtare të STIKK si dhe studenteve të Teknologjisë se Informacionit. Në këtë trajnim morën pjese 11 pjesëmarrës prej të cilëve 4 ishin femra dhe 7 meshkuj.

Modulet e trajnimit ishin:

- CRM Software;
- Zhvillimi dhe analizimi i planit për CRM;
- Automatizimi dhe sinkronizimi i departamenteve të shitjes, marketingut, shërbimit ndaj klientit dhe mbështetjes teknike nëpërmjet CRM;
- Rritjen e vlerës se organizatës dhe konsumatorit nëpërmjet CRM.

Në fund te trajnimit pjesëmarrësit pranuan certifikatat e tyre të pjesëmarrjes.

6 Qershor 2014

TRAJNIMI MBI MENAXHIMIN E SHITJES

Një tjetër trajnim i mbajtur në kuadër të STIKK Training Academy ishte Menaxhimi i Shitjes i cili u mbajt nga data 2-6 Qershor, me ligjërues z. Diedon Kica. Në këtë trajnim morën pjesë 10 pjesëmarrës prej të cilëve 4 ishin femra dhe 6 meshkuj. Pjesëmarrësit kryesisht ishin nga kompanitë anëtare te STIKK si dhe studente të Marketingut.

Gjate trajnimit pjesëmarrësit mësuan:

- Shitjen dhe rolin e saj ne Biznes;
- Shitjen ne Industrinë e TIK;
- Menaxhimin e Produkteve dhe Operimin e Shitjeve;
- Shitjen, Menaxhimin dhe Lidershipin.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit morën certifikatat e tyre të pjesëmarrjes dhe ishin shume entuziast të shihnin se si do të i praktikonin të gjitha gjerat e mësuara në punën dhe jetën e tyre të përditshme.

29 Gusht 2014

ÇMIMI " SPECIAL MENTION AWARD" NGA JURIA IU NDA EKIPIT GARUES TË KOSOVËS CILËT ZHVILLUAN WEB APLIKACIONIN 101 CITY PËR TË LEHTËSUAR JETËN E PËRDITSHME TË QYTETAREVE TË KOSOVËS

Pas një periudhe mësimore prej katër muaj, të iniciuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), me datën 29.07.2014, dhjetë fëmijë nga Kosova filluan punën e tyre për pjesëmarrje në garën ndërkombëtare *"Festival of Code"* e cila organizohet tashmë për herën e gjashtë nga Young Rewired State në Angli.

Fëmijët nga Kosova për 4 ditë rresht punuan në zhvillimin e një aplikacioni të cilin ata e identifikuan si të nevojshëm për lehtësimin e jetës së qytetarëve tanë si dhe të turistëve të cilët vizitojnë vendin tonë. Të martën me datën 29. 07.2014, në ambientet e Qendrës se Inovacionit të Kosovës (ICK), partnerë e projektit, 10 fëmijët u ndanë në tri ekipe, dhe prezantuan idetë e tyre para të pranishmeve. Ideja e përgjithshme ishte krijimi i një aplikacioni me tri module, i cili do të mundësojë informata për orarin e reduktimeve të ujit, orarin e grumbullimit të mbeturinave dhe njëkohësisht paraqitjen e ankesave në rast të parregullsive, si dhe moduli i tretë i cili përfshin një listë të vendeve të cilat mund të vizitohen sikurse monumentet historike, muzetë, orarin e shfaqjeve në kinema, teatër dhe aktivitetet rekreative të cilat janë në dispozicion në vendin tonë. Aplikacioni u emërtua 101City (qyteti101).

Përgjatë javës fëmijët punuan me intensitet nën mbikëqyrjen e udhëheqësit Driton Haxhiu, si dhe me mentorët Doruntina Sadiku, Fitore Salihu dhe Enkela Osmani. Përkrahja nuk mungoi as nga kompanitë anëtare, anëtaret individual dhe projektet tjera partnere të Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK) të cilët ndanë përvojën e tyre dhe u dhanë këshilla fëmijëve gjatë punës së tyre. Pas dorëzimit të idesë, erdhi lajmi se ekipi i fëmijëve nga Kosova do të jenë në finale duke garuar me 20 ide të tjera. Të dielën me datën 3 gusht, 2014 në ora 13:00 Kosova u prezantua me përfaqësuesit e saj më te rinj përmes video xhirimit në *"Festival of Code"* e cila sivjet u mbajt ne Plymouth, të Britanisë së Madhe. Në fund të kësaj dite fëmijëve u ndanë 10 tableta, përmes sponsorit Empowering Youth Employement (EYE) financuar nga Projekti Zviceran për Zhvillim SDC. Megjithatë, befasia e vërtet erdhi kur juria ndau çmimin *"Special Mention Award"* me ç'rast fëmijëve do të u dhurohen edhe 10 Rasspbery Pi, dhe do të u ndahen certifikata për pjesëmarrjen e tyre të parë në këtë festival. Kjo ngjarje gjithashtu u përkrah nga IpkoFoundation, Frutomania, City Bakery dhe Proper Pizza.

13 Qershor 2014

TRAJNIMI NË MARKETING & PROMOTION

STIKK Training Academy duke filluar prej datës 9 deri 13 Qershor, 2014 organizoi trajnimin 5 ditor në Marketing & Promotion me ligjërues z. Valon Canhasi. Ky trajnim i është dedikuar të gjithë studentëve të TIK dhe anëtarëve të STIKK-ut.

Në këtë trajnim pjesëmarrësit kanë pasur rastin të mësojnë:

- Kuptimin e procesit te Marketingut;
- Analizën e situatës se Marketingut;
- Metodat e marrjes se informacionit;
- Analizën e tregut dhe segmentimin e produkteve;
- Strategjinë e Marketingut;
- Planifikimin e çmimeve dhe planin e shpërndarjes.

Në fund të trajnimit pjesëmarrësit kanë praktikuar të gjitha metodat e mësuara në praktike që të shohin se si realisht funksionojnë te gjitha konceptet e shpjeguara. Për këtë trajnim, të gjithë pjesëmarrësit ditën e fundit pas testit provues pranuan një certifikatë të pjesëmarrjes.

27 Nëntor 2014

TRAJNIMI I MENAXHIMIT TË MARRËDHËNIEVE ME KONSUMATORË (CRM)

Në kuadër të STIKK Training Academy nga data 17 - 21 Nëntor u mbajt trajnimi Menaxhimi i marrëdhënieve me konsumatorë (CRM) ligjëruar nga Dario Car, i cili iu dedikua te gjitha kompanive anëtare te STIKK si dhe studenteve te Teknologjisë se Informacionit. Ne këtë trajnim morën pjese 16 pjesëmarrës prej te cilëve ishin femra 8 dhe 8 meshkuj.

Në këtë trajnim pjesëmarrësit mësuan:

- CRM Software;
- Zhvillimin dhe analizimin e planit për CRM;
- Automatizimin dhe sinkronizimin e departamenteve të shitjes, marketingut, shërbimit ndaj klientit dhe mbështetjes teknike nëpërmjet CRM;
- Rritjen e vlerës se organizatës dhe konsumatorit nëpërmjet CRM.

19 Dhjetor 2014

PËRMBYLLJA E CIKLIT TË TRAJNIMEVE PËR VITIN 2014 ME TRAJNIMIN CUSTOMER RELATIONSHIP MANAGEMENT (CRM)

Me 19 Dhjetor, me kerkesen e shtuar, u mbajt edhe njehere trajnimi për Marrëdhënieve me Konsumatorë (CRM), me ç'rast edhe u përmbyll viti 2014 sa i përket trajnimeve. Në këtë trajnim moren pjese 17 pjesëmarrës (prej të cileve 8 ishin femra).

Objektivi 3: Ofrimi i shërbimeve për anëtarë me qëllim të krijimit të mundësive të reja biznesore

14 Mars 2014

STIKK DHE ANËTARËT E SAJ MARRIN PJESË PËR HERË TË 5-TË NË CEBIT

STIKK së bashku me Adaptivit, Harrisia, ICK, IziSurvey dhe ZagApps morën pjesë në CeBIT 2014 për herën e 5-të me radhë. Gjate këtyre pesë ditëve, kompanitë anëtare të STIKK patën mundësi të takohen me partnerë/investitorë potencial, të promovojnë kompanitë si dhe sektorin e TIK të Kosovës si një destinacion potencial për outsourcing.



Donatorë: spark ignites ambition, giz, NORWEGIAN MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS, IPAK Investment Promotion Agency of Kosovo

27 Shkurt 2014

ICT-KOSEU: SEANCE INFORMUESE PËR PJESËMARRJE NË HORIZON2020 ME FOKUS NË TIK

STIKK, si partnere e projektit ICT-KOSEU, organizoi seancën informuese lidhur me pjesëmarrjen e Kosovës në kornizën e re të Komisionit Evropian Horizon2020, në ambientet e MASHT. z. Ulrich Boes, nga URSIT, Bullgaria gjithashtu partner i projektit ICT-KOSEU u ofroi pjesëmarrësve të takimit njohuri të përgjithshme për kornizën HORIZON2020.

Qëllimi kryesor i kësaj kornize ishte thjeshtësimi i disa aspekteve në krahasim me kornizën paraprake, megjithatë ende ka rregulla të shumta të cilat duhen zbatuar. HORIZON2020 do të përkrahë të gjitha shkallet e zinxhirit të hulumtimit dhe inovacionit, dhe rangimet e ndryshme të financimit në bazë të parimit sa më afër tregut të jetë aktiviteti përkrahës aq më të mëdha duhet të jenë financimet nga burimet tjera.

20 Mars 2014

"FUTURE INTERNET ASSEMBLY – FIA ATHENS 2014" BASHKON PALËT E INTERESIT TË INTERNETIT EVROPIAN PËR TË RIFORMATUAR INFRASTRUKTURËN E ARDHSHME TË INTERNETIT PËR INOVACIONIN

FIA Athens 2014 konferenca është bashkëpunim i më shumë se 150 projekteve, me qellim të fuqizimit të aktiviteteve evropiane për të mundësuar konkurueshmërinë e Evropës në tregun botëror. Pjesa tematike e konferencës sillej rreth formulimit të peizazhit të ri teknologjik të internetit, të bazuar në *"network/cloud integration & virtualization"* dhe softuerëve, shërbimeve dhe *"cloud"* teknologjisë që mundësojnë zhvillimin e aplikacioneve inovative. Në këtë konference, përveç DE të STIKK morën pjesë edhe 4 përfaqësues të Kosovës: 1 përfaqësues i kompanive, 1 përfaqësues i qeverisë dhe 2 përfaqësues të institucioneve edukativo arsimore.

23 Mars 2014

STIKK MERR PJESË NË PUNËTORINË E RADHËS SË OGP-SË

STIKK mori pjesë në punëtorinë e organizuar nga Ministria e Integrimit Evropian, e mbajtur në Bogë, Pejë. Gjatë kësaj punëtorie, STIKK së bashku me shoqërinë civile, pati një rol mbështetës për përmirësimin e Planit Nacional të Veprimit 2014-2016, në kuadër të anëtarësimit të Kosovës në Open Government Partnership. OGP është një iniciativë e cila synon të sigurojë angazhime konkrete nga ana e qeverisë për të nxitur transparencën, fuqizimin e qytetarëve, të luftojë korrupsionin, dhe të shfrytëzojë teknologjitë e reja dhe inovacionin për të forcuar qeverisjen. Kosova pretendon të bëhet anëtarja e 64-të e OGP-së në botë. Në Planin Nacional të Veprimit për OGP-së është paraparë që uebserviset dhe softuerët të bëhen në bashkëpunim midis Qeverisë dhe sektorit privat biznesor të TIK-ut.

28 Mars 2014

DREJT 2020: HORIZONTE TË REJA PËR HULUMTIM DHE ZHVILLIM NË TEKNOLOGJI DHE INOVACION NË REGJIONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

U mbajt konferenca përfundimtare e projektit WBC-INCO.NET e titulluar Drejt 2020: Horizonte të reja për Hulumtim dhe Zhvillim Teknologjik dhe Inovacion në Regjionin e Ballkanit Perëndimor. STIKK përmes projektit ICT-KOSEU mundësoi pjesëmarrjen e 7 pjesëmarrësve nga Kosova, duke përfshire këtu përfaqësues nga bizneset, akademia dhe qeveria. Kjo ngjarje ka sjellë bashke mbi 100 hulumtues, vendimmarrës, dhe përfaqësues të industrisë nga regjioni i Ballkanit Perëndimor, EJL, Regjioni i Danube-it dhe gjithashtu shtete tjera të BE-së të cilat janë të interesuara për bashkëpunim me shtetet e BP.

5 Korrik 2014

PËRFAQËSUESIT E PARLAMENTIT HOLANDEZ VIZITUAN KOMPANITË ANËTARE TË STIKK

Në kuadër të projektit *"ICT Value Chain"* të udhëhequr nga organizata holandeze SPARK, me datën 05 Korrik 2013, z. Jan Vos përfaqësuesi i parlamentit holandez, realizoi disa takime me kompanitë anëtare te STIKK.

Qëllimi kryesor i këtyre vizitave ka qenë identifikimi dhe promovimi i kompanive të profilit të TIK, të cilat kanë potencial për investime. Gjate këtij takimi kompanitë patën mundësinë e prezantimit të veprimtarisë së tyre të tanishme dhe planet e tyre afatgjatë.

5 Korrik 2014

STIKK MERR PJESË NË FORUMIN "GRATË E DIASPORËS NË BIZNES"

Me 26 Korrik 2013 STIKK mori pjesë në forumin *"Gratë e Diasporës në Biznes"* i organizuar nga Ministria e Diasporës, gjegjësisht Departamenti për Hulumtim dhe Përkrahje të Investimeve të Diasporës. Të pranishme ishin rreth 120 gra afariste të suksesshme që udhëheqin bizneset e tyre nga Kosova, rajoni dhe diaspora, përfaqësuese nga organizatat ndërkombëtare, UNDP-së në Kosovë, USAID-it në Kosovë dhe organizatat tjera të ndryshme.

Qëllimi i këtij projekti ishte që gratë nga Kosova, diaspora dhe rajoni të njoftohen për së afërmi me veprimtarit e njëra tjetrës, të identifikohen format e bashkëpunimit, shkëmbim idesh dhe përvojash, krijimi i rrjetëzimit të grave afariste.

01 Tetor 2014

MISIONI EKONOMIK "NEARSHORING KOSOVO"

Më 01.10.2014 në ICK u mbajt Misioni Ekonomik *"Nearshoring Kosovo"* ngjarja B2B e organizuar nga Oda Ekonomike Austriake në bashkëpunim me STIKK dhe ICK. Ne këtë ngjarje morën pjesë pesë kompani Austriake dhe kompani nga Kosova të cilat prezantuan veprimtarinë e tyre me qëllim të identifikimit të mundësive për krijimin e partneriteteve.

Kompanitë pjesëmarrëse Austriake dhe Kosovare ishin:

- Matting management partners Gmbh, MeBtechnik Gesellschaft, Reiwag facility services Gmbh, Open research software development OG, WIFI international.
- Adaptiv IT, Appdec, Frakton, Rrota, Tekkos, Trigonom, Ameble, Trokit Agency Creative, WIFI Albania, Cloud, Mikrobiz, MTI-KIESA, Hello world, Aca, Solaborate.

Takimi u hap nga z. Peter Hasslacher, përfaqësuesi i Odes ekonomike Austriake , i cili u dëshiroi mirëseardhje kompanive pjesëmarrëse, kurse znj. Vjollca Cavolli, Drejtoreshe Ekzekutive e STIKK, pati një prezantim të shkurtër të STIKK dhe sektorit të TIK në Kosovë duke shpresuar në bashkëpunime të mundshme në mes të kompanive të dy shteteve.

1 Tetor 2014

FORUMI GJERMAN I ITO & BPO 2014

Me 1 Tetor, 2014 STIKK mori pjesë në Forumin Gjerman 2014 të ITO dhe BPO e cila u mbajt në Berlin të Gjermanisë. STIKK gjatë këtij udhëtimi pati mundësinë të takohet me disa partnerë potencial me qëllim të rritjes së vizibilitetit të Kosovës dhe me theks të veçantë sektorit të TIK dhe anëtarëve të saj. Gjatë këtij udhëtimi STIKK u takua me BITKOM – Shoqata Federale e Teknologjisë së Informacionit, ku u diskutuan mundësitë e ndarjes se informatave si dhe projektet e mundshme të përbashkëta në kuadër të kornizës së re të KE Horizon2020. Gjithashtu, u adresua mundësia e përfshirjes së Kosovës në raportet e tregjeve të EITO (European IT Observatory).

ITO&BPO Germany Forum është ngjarja e vetme ndërkombëtare për industrinë e ITO&BPO, për shkëmbimin e praktikave të mira, informatat lidhur me destinacionet dhe modelet e bizneseve. Ngjarja është jo komerciale, e pavarur dhe e organizuar nga ekspertet e industrisë. Kjo ngjarje është fokusuar në prezantimin e praktikave më të mira si dhe destinacionet ITO&BPO nga Ukraina, Bulgaria dhe shumë shtete tjera të suksesshme të cilat tani janë destinacione të favorshme për eksportimin e shërbimeve dhe gjithashtu kanë siguruar informata të dobishme mbi atë se në çfarë duhet të përqendrohet një shtet në mënyrë që të rritë vizibilitetin dhe të bëhet një IT Outsourcing Destination.

13 Tetor 2014

MISIONI TREGTRAR I EJL NË VJENË, MUNIH DHE SHTUTGART

Në kuadër të projektit GIZ ORF për zhvillimin e strategjisë së Evropës Juglindore për eksport të TI, STIKK së bashku me partnerët e regjionit vizituan shoqatat e TIK në Vienë, Munih dhe Shtutgart prej datës 7 deri më 10 Tetor me qëllim te promovimit të potencialit të sektorit të TIK të EJL dhe eksportimin e shkathtësive. Së bashku me partnerët nga regjioni I EJL, STIKK nënshkroi Marrëveshjen e bashkëpunimit me BiccNet (Munich) dhe MFG/bwcon (Stuttgart) në mënyrë që të fuqizojë bashkëpunimin lidhur me projektet e përbashkëta dhe mundësitë biznesore.

1 Nëntor 2014

KOSICT 2014

Me datën 30 Tetor 2014, filloi edicioni i tretë i konferencës KosICT, i organizuar nga STIKK dhe ICK. KosICT kësaj radhe mblodhi mbi 200 profesionistë të fushës së TIK për të diskutuar trendët më të reja në sektor për tri ditë me radhë. Konferenca u hap nga z. Shkumbin Brestovci, Kryetar i Bordit të STIKK, ndërsa pas tij audiencës iu drejtuan edhe Zëvendës Ambasadorja Norvegjeze znj. Katherina Ramberg si dhe Zëvendës Ambasadori z. Matthias Kiesler. Këtë vit KosICT solli risi edhe për zhvilluesit softuerik me seancën paralele të konferencës, ku u shtjelluan tema si: Cross platform mobile development, 3D Printing technology, Programming with SWIFT, How to develop apps for Windows. Dita e parë e konferencës u përmbyll me një seancë tejet mbresëlënës në temën Entepreneurship dhe Open Innovation, nga z. Baybar Altuntas (EBAN), Vllaznim Xhiha (EYE) and Ivo Betke (webcrowd). Njëkohësisht, kompanitë kosovarë patën mundësinë të zhvillojnë takime me kompani nga Gjermania dhe Norvegjia në seancën e veçantë B2B.

Diskutimet në panel kanë përfshire tema si: "Gjetja e start-up've dhe ndihma për rritjen e tyre" me folësit vendor dhe ndërkombëtar si Kushtrim Xhakli (Fast Europe Ventures), Michael Gold (Crimson Finance Fund/KosBAN), Murry Ivanoff (Metrilo/Eleven), Can Saracoglu (String Ventures) dhe Irina Chaushevska (NewMan's Business Accelerator). Ndërsa më pas u vazhdua me temën "Si të ndërtojmë një komunitet të investitorëve engjuj" (Angel Investor Community) me Toby Stone, Uranik Begu, Alejtin Berisha (KosBAN) dhe Baybars Altuntas (EBAN). Dita e dytë e konferencës u përmbyll me praktikat e mësuara nga Turqia nga Can Saracoglu. Në ditën e fundit të KosICT u mbajt një fjalim i shkurtër se si ndërmarrësit apo drejtuesit e një biznesi fillestar duhet te prezantojnë idetë e tyre para investitorëve. Më pas, rreth 6 ekip patën mundësinë të prezantojnë idetë e tyre para panelit vlerësues. Kjo ishte një mundësi e veçantë jo vetëm në aspektin e përsosjes së shkathtësive tyre për prezantim profesional të biznesit, por gjithashtu një mundësi e cila do të hapë dyert për tërheqjen e investitorëve. KosICT është konferencë tradicionale e cila çdo vit sjell tema me interes për sektorin.

01 Nëntor 2014

B2B MATCHMAKING SESSION NË KOSICT 2014

Gjatë konferencës së KosICT 2014, gjithashtu është përgatitur një sesion për Business-to-Business matchmaking ndërmjet kompanive Kosovare, Gjermane dhe Norvegjeze. Në total ishin 30 kompani të cilat morën pjesë, 6 nga Norvegjia, 4 nga Gjermania dhe 20 nga Kosova. Ky sesion përmbylli ditën e parë të konferencës dhe do rezultatet e saja do të vërehen në vitet e ardhshme.

Organizata Athene prosjektledelse ka përgatitur një video për këtë aktivitet dhe atë mund ta shihni duke klikuar në këtë link.

Objektivi 4: Krijimi i kushteve për veprimtari të qëndrueshme të STIKK-ut

25 Mars 2014

STIKK MERR PJESË NË JAVËN E GRUAS

Dita e dytë e Javës së Gruas u mbajt në ambientet e ICK-së, ku u fokusua në temën Gratë dhe Teknologjia. Pjesëmarrëse ishin mbi 100 gra nga e tërë Kosova, që ishin përfaqësuese të partive politike, shoqërisë civile, biznesit, mediave, botës akademike, si dhe mysafirë tjerë. Gjatë kësaj dite u mbajt një seancë diskutimi, e cila është moderuar nga: Donika Kadaj Bujupi - deputete e Kuvendit të Kosovës, ndërsa diskutues ishin: Uranik Begu nga ICK, Vlora Çitaku - Ministre për Integrim Evropian, Vjollca Çavolli nga STIKK, Milena Harito - Ministre e Inovacionit dhe Administratës Publike (Shqipëri), Mimoza Hajdarmataj - koordinatore lokale e rrjetit të grave *"Barazia në vendimmarrje, Shqipëri"* si dhe Kristina Wilfore nga NDI. Në diskutimin e saj, znj. Vjollca Çavolli potencoi rolin e grave në politike përmes teknologjisë, ku preku temat si: mungesa e grave në teknologji, përparësitë që ofron teknologjia për gratë, krijimin e komuniteteve në rrjetet sociale për të shtyrë qëllimet përpara, rolin e STIKK-ut në promovimin dhe rritjen e kapaciteteve të grave në teknologji të informacionit, e të tjera.

27 Mars 2014

"PËRDORIMI I MEDIAVE SOCIALE NË KOMUNIKIMIN KOMUNË-QYTETARË"

Internews Kosova në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese, kanë organizuar tryezën *"Përdorimi i mediave sociale në komunikimin komunë-qytetarë"* me 27 mars në hotel Dukagjini ne Pejë. Në këtë tryeze STIKK në rolin e panelistit prezantoi trendët e rritjes se shfrytëzuesve të internetit në Kosovë si dhe ndikimin e aktiviteteve të STIKK në këto trende. Gjithashtu në këtë tryeze z.Valon Canhasi nga STIKK, tregoi se si mund të bëhen analizat e të dhënave përmes Google Analytics dhe Facebook Analytics.

17 Prill 2014

STIKK MBLEDH KOMPANITË E SEKTORIT TË TIK NË KUVENDIN E GJASHTË

Me datën 17.04.2014 në ambientet e Qendrës Inovative të Kosovës, u hap Kuvendi i gjashtë i radhës i Shoqatës për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK). Anëtarëve të STIKK iu drejtua Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Bernard Nikaj i cili e përgëzoi Shoqatën për punën e bërë gjatë këtyre gjashtë viteve dhe e cilësoi STIKK-un si *"Shoqata më llogaridhënëse sa i përket qeverisjes së mirë ne krahasim me shoqatat tjera"*. Ai cilësoi se ky sektor është përcaktuar si sektor prioritar i qeverisë dhe theksoi se: *"edhe pse janë bërë disa lehtësime për sektorin në veçanti në politika fiskale, përpjekjet e Ministrisë do të vazhdojnë në krijimin e ambientit më të favorshëm duke thënë se ai personalisht do të jetë avokat i këtyre lehtësimeve."*

Audiencës iu drejtua edhe përkrahësi i devotshëm i sektorit të TIK në Kosovë ambasadori Norvegjez z.Jan Braathu. *"Industria e TIK të Kosovës ka arritur një zhvillim dhe rritje të mahnitshme brenda gjashtë viteve të fundit. Që nga fillimi i vitit 2008, Shoqata ka qenë pjesë integrale e këtij zhvillimi. Kam guximin të them se sektori i TIK të Kosovës është një ndër sektorët më të organizuar në Kosovë, madje edhe ne rajon- duke iu falënderuar STIKK"*, theksoi ambasadori që në fillim të fjalimit të tij. Ambasadori gjithashtu theksoi vështirësitë me të cilat sektori po ballafaqohet duke vënë theksin në dy më të rëndësishmet: edukimin dhe politikat qeveritare për ambientin e përgjithshëm biznesor. Ai gjithashtu tha se Qeveria Norvegjeze ka qenë përkrahëse e sektorit të TIK në Kosovë vite me radhë dhe se do të vazhdojë në këtë drejtim, megjithatë krahas kësaj duhet të kuptohet se suksesi përfundimtar do të varet nga vetë palët e interesit në Kosovë.

Z. Ilir Rexha nga GIZ gjithashtu e përgëzoi Shoqatën për punën e saj të deritanishme dhe theksoi se tashmë është themeluar një bashkëpunim i mirëfilltë Gjermano-Kosovar në këtë sektor, dhe se GIZ do të vazhdojë përkrahjen për STIKK dhe promovimin e sektorit në tregjet e jashtme.

Më pas z. Dardan Vokshi, Nën- Kryetar i Bordit të STIKK prezantoi punën e Bordit dhe aktivitetet ndërkombëtare të shoqatës. Ndërsa, Drejtoresha Ekzekutive e STIKK znj. Vjollca Çavolli prezantoi punën një vjeçare të Shoqatës. Kuvendi vazhdoi punimet pasdite me ç'rast u miratuan ndryshimet në Statutin e STIKK dhe u zgjodhën 4 anëtarë të rinj të Bordit. Gjithashtu, kuvendi miratoi raportin vjetor të STIKK, u prezantua Plani i punës dhe buxheti për vitin 2014; u prezantuan dhe miratuan pakot e reja të anëtarësisë dhe u përzgjedh kompania e cila do të bëjë auditimin e Shoqatës gjatë tre viteve të ardhshme.

16 Maj 2014

KONSULTIMI PUBLIK DHE PREZANTIMI I PROGRAMIT IPA II – BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR 2014-2020 KOSOVE – ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

Me datën 16 maj 2014, STIKK mori pjesë në konsultimin publik dhe prezantimin e programit IPA II - bashkëpunimi ndërkufitar 2014-2020 Kosovë-Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e organizuar nga EU IPA CBC Programme, e cila u mbajt në Gjilan.

Në këtë takim morën pjesë; përfaqësuesi i Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal, përfaqësuesi i CBIB+, kryetari i komunës së Vitisë, nën-kryetari i komunës së Gjilanit dhe pjesëmarrës nga shoqëria civile dhe akademike. Qëllimi i këtij konsultimi dhe prezantimit publik ishte që të informojë publikun e gjerë dhe palët e interesuara me draft versionin e Programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II ndërmjet Kosovës dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për periudhën 2014-2020.

21 Maj 2014

"E-LEADERSHIP REGIONAL CLUSTER EVENT"

Me 21 Maj, 2014 STIKK mori pjesë në ngjarjen *"e-Leadership Regional Cluster Event"* e cila u mbajt në Sofje, Bullgari.

Kjo ngjarje u organizua nga ESI Center dhe kishte për qellim adresimin e temave si e-leadership dhe e-kompetencës në industri të TI-së. Folës ne këtë konferencë ishin Dr. Paul Nielsen nga SEI-CMU, Richard Soley nga OMG, André Richier nga the European Commission DG Enterprise and Industry dhe shumë të tjerë.

11 Korrik 2014

5 VJETORI I DITËS MBARËKOMBËTARE TË TIK

Me 11 Korrik për herë të pestë u mbajt Dita mbarëkombëtare Shqiptare e Teknologjisë së Informacionit dhe komunikimit, në Prizren, e organizuar nga STIKK dhe AITA, ku morën pjesë përfaqësues nga kompanitë private, komuniteti i profesionisteve si dhe organizata dhe donatorë të huaj, kryesisht të sektorit të Teknologjisë së Informacionit.

Gjatë këtij takimi kompanitë e pranishme patën rastin të takohen mes vete, dhe me përfaqësues institucionesh shtetërore dhe ndërkombëtare.

23 Korrik 2014

GIZ OFRON DONACION STIKK-UT

Me datën 23 Korrik në STIKK arritën katër tabela (pin boards) nga Frankfurti, të cilat u dhuruan në kuadër të një donacioni nga ana e GIZ.

Ky donacion ishte më se i mirëseardhur për Shoqatën për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës, dhe konsiderohet si një ndihmesë e madhe e cila do të lehtësojë punën e shoqatës.

Me rastin e dhurimit të këtij donacioni, udhëheqësja e ekipit të projekteve të GIZ për Kosovë, znj. Veronika Hofinger, përgëzoi STIKK-un për punën e saj të deritanishme dhe theksoi se tashmë është themeluar një bashkëpunim i mirëfilltë Gjermano-Kosovar në këtë sektor, dhe se GIZ do të vazhdojë përkrahjen për STIKK edhe në të ardhmen.

3 Gusht 2014

MBULIMI MEDIATIK I PROJEKTIT "YOUNG CODERS KOSOVO"

Për herë të parë Kosovo Young Coders kanë konkurruar në *"Festivalin e Kodit"* i cili është pjesë e Young Rewired State (YRS), një rrjet i pavarur global i të rinjve nën moshën 18 vjeçare të cilët kanë aftësi programuese. Duke filluar nga data 29 Korrik deri më 3 Gusht, 10 fëmijë të moshës 9-15 vjeç nga Kosova kanë konkurruar me bashkëmoshatarët e tyre rreth e rrotull globit. Projekti *"Young Coders"*, i cili ka përfaqësuar Kosovën për herë të parë në këtë konkurs, u iniciua nga Shoqata Kosovare e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (STIKK), në bashkëpunim me Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK). Një ngjarje e tillë, sidomos në Kosovë kishte nevojë për vëmendje të madhe në mënyrë që në të ardhmen ky projekt të zhvillohet edhe më tutje, dhe mënyra më e mirë për të bërë këtë ishte duke e ndarë këtë lajm nëpërmjet mediave. Shumë media të njohura ndërkombëtare dhe lokale kanë ndarë lajmin se Kosova tani është pjesë e *"Festivalit të Kodit"*.

Mediat në vazhdim kanë mbuluar projektin *"Young Coders Kosovo"*:

The Guardian | Young Rewired State | Innovation Centre Kosovo | Prishtina Magazine | Kosovari Media | Kosovalive360

13 Gusht 2014

KRYETARI I PRISHTINËS, SHPEND AHMETI VIZITOI "PROGRAMERËT E RINJ"

Më 13 gusht 2014, Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti vizitoi "Programerët e Rinj" në hapësirat e ICK-së. "Programerët e Rinj" është një grup nga Kosova që përfshin 10 fëmijë të cilët pas një periudhe mësimore prej katër muajsh, të iniciuar nga Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës (STIKK), në bashkëpunim me Qendrën e Inovacionit të Kosovës (ICK), morën pjesë në garën ndërkombëtare *"Festival of Code"* e cila u organizua nga Young Rewired State në Angli, prej datës 29 korrik deri më 3 gusht të këtij viti.

Dhjetë programerët tanë të rinj për 4 ditë rresht punuan në zhvillimin e një web aplikacioni të emërtuar 101 city (qyteti 101), të cilin ata e identifikuan si të nevojshëm për lehtësimin e jetës së qytetarëve të Kosovës si dhe të turistëve të cilët zgjedhin të vizitojnë vendin tonë. Puna e palodhshme e këtij grupi punëtor drejt krijimit të aplikacionit u shpërblye me çmimin e veçantë *"Special Mention Award"* i cili iu nda ekipit garues nga juria e Festivalit të Kodit.

Gjatë vizitës, Kryetari Ahmeti pati mundësinë të i shikojë edhe një herë prezantimet e fëmijëve dhe më pas theksoi se Komuna të cilën ai e drejton do të vazhdojë të mbështesë këtë grup dhe programe të tjera të ngjashme nëpër shkolla fillore, tani që *"Smart Cities"* dhe teknologjia janë pjesë e pandashme dhe e domosdoshme e së ardhmes.

7 Nëntor 2014

TRAJNIMI PER AVOKIM DHE LOBIM

STIKK mori pjesë në trajnimin Avokim dhe Lobim i cili u mbajt në Mitrovicë nga data 3-7 Nëntor me trajnerin Z. Simon White i cili kishte eksperiencë shumë vjeçare në fushën e avokimit dhe lobimit në vendet në zhvillim.

Gjatë 5 ditëve të trajnimit u shpjeguan mënyrat e zhvillimit të strategjisë dhe krijimit të agjendës së avokimit, teknikat për një avokim biznesi të suksesshëm, si dhe menaxhimi i strategjisë së avokimit dhe lobimit. Dy ditët e fundit të trajnimit pjesëmarrëse iu kërkua që të krijonin një plan të veprimit të avokimit dhe lobimit në kuadër të veprimtarisë së tyre i cili duhet zhvilluar gjatë vitit 2015.

20 Nëntor 2014

STIKK MORI PJESË NË TRAJNIMIN RRETH SHKRIMIT TË PROJEKT PROPOZIMËVE (PPW)

Dy nga stafi i STIKK morën pjesë në trajnimin për PPW organizuar në objektet e kolegjit IBCM në Mitrovicë, i cili ishte i udhëhequr nga Z. Fatmir Bytyqi, i cili mësoi grupin për këshilla në shkrimin e projekt-propozimeve që synojnë fondet e BE-së.

Gjatë këtij trajnimi tre-ditor, pjesëmarrësit mësuan më shumë se si të i qasen e thirrjeve për aplikantët, si të analizohen me kujdes udhëzimet, si të rezultojë në zgjidhje të efektshme të aktiviteteve të projektit, dhe këshilla që ndihmojnë të shtyjnë projektin në një nivel më të lartë. Trajnimi u përmbyll me një përmbledhje të shkurtër mbi përgatitjen e buxhetit dhe mbi rregullat për dorëzimin e projektit të BE-së.

10 Dhjetor 2014

PREZANTIM I STIKK PARA MINORITETEVE

Zotëri Bardh Kadiu, Kordinator i Programeve në STIKK, prezantoj shoqatën para 40 studenteve dhe profesionalisteve nga komuniteti Serb në Kosovë. STIKK me këtë rast promovoi përfshirjen e minoriteteve në industrinë e TIK në Kosovë.

19 Dhjetor 2014

FESTA E FUNDVITIT 2014

Edhe këtë vit, STIKK dhe ICK kanë vazhduar traditën e festës së fundvitit, festë kjo e mbajtur me 19 Dhjetor në Morena Bar, Prishtinë. Ne këtë feste morën pjese kompanitë anëtare te STIKK, kompanitë start-up te ICK-së, përfaqësues te institucioneve te larta te edukimit si dhe mysafire te shumte, miq dhe përkrahës te sektorit te TIK.

Objektivi 5: Mbështetja e anëtarëve në ushtrimin e përgjegjësisë sociale në sektorin e TIK

7 Prill 2014

DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT NGA STIKK , ICK DHE ATHENE

Në ambientet e Innovation Centre Kosovo (ICK) është mbajtur aksioni i dhurimit të gjakut që u organizua për të shënuar Ditën Botërore të Shëndetit - që çdo vit shënohet më 7 Prill. Në aksionin për dhurimin vullnetar të gjakut kanë marrë pjesë 20 dhurues. Dhuruesit kanë qenë nga ICK, STIKK, Athene Kosovo, ekipet e inkubatorit të ICK-së, përfaqësues te kompanive anëtare te STIKK si dhe njerëz të tjerë që nuk janë pjesë e qendrës. Aksioni i dhurimit të gjakut u mbajt në zonën *"Events Area"*, ku në dispozicion ishin 5 shtretër që së bashku me pajisjet tjera përcjellëse u siguruan nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut. Ky aksion do të përsëritet edhe në shtator.

19 Shtator 2014

DHURIMI VULLNETAR I GJAKUT NGA STIKK, ICK DHE KOMPANITË ANËTARE TË STIKK

Në ambientet e Innovation Centre Kosovo është mbajtur aksioni i dhurimit të gjakut e cila është bërë tashme tradite e shoqatës sonë. Në aksionin për dhurimin vullnetar të gjakut kanë marrë pjesë 30 dhurues. Dhuruesit kanë qenë nga Innovation Centre Kosovo (ICK), STIKK, Athene Kosovo, ekipet e inkubatorit të ICK-së, përfaqësues te kompanive anëtare te STIKK si dhe njerëz të tjerë që nuk janë pjesë e qendrës. Aksioni i dhurimit të gjakut u mbajt në zonën *"Events Area"*, ku në dispozicion ishin 4 shtretër që së bashku me pajisjet tjera përcjellëse u siguruan nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut.

11 Dhjetor 2014

VIZITË NGA NXËNËSIT E SHKOLLËS "MILENIUMI I TRETË"

Nxënës nga shkolla *"Mileniumi i Tretë"* vizituan STIKK dhe ICK për të mësuar më shumë rreth ambientit tonë inovativ. STIKK dhe ICK prezantuan punën e tyre dhe projektet të cilat kanë për qëllim përkrahjen e të rinjve në implementimin e zgjidhjeve kreative të problemeve të ndryshme me të cilat ballafaqohet shoqëria jonë. Gjithashtu, gjatë takimeve u shkëmbyen perspektivat e ndryshme rreth krijimit të kushteve që nxënësit të arrijnë potencialin e tyre maksimal duke menduar ndryshe.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET

Të hyrat

Gjatë vitit 2014, të hyrat e STIKK ishin 319,007€ (15.51% më pak krahasuar me 368,488€ të vitit 2013) dhe atë nga 12 burime të mjeteve: Qeveria Norvegjeze përmes Athene (projektet Growth, ICK, Wominnovation dhe HERD), SPARK, FP7, SDC, British Council, Ambasada Norvegjeze, GIZ, Helvetas dhe Anëtarët e STIKK (anëtarësia, participimi në trajnime dhe aktivitete tjera). Detajet e të hyrave janë të prezantuara në tabelën në vazhdim:

		STIKK	Athene Prosjektledelse AS				SPARK	EU - FP7	SDC/Helvetas	British Council	Royal Norwegian Embassy	GIZ	HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Ipko Foundation	TOTAL
			Growth Programme	ICK	Womminovation	HERD/AEP	MFS II	ICT - KOSEU			National Kosovo IT Strategy	Local Subsidy 2014	Young Coders	
TË HYRAT														
	Anëtarësimi	14,550.00												**14,550**
	Programet: Donacionet/Grantet	18,136.64	19,965.40	24,996.00	1,570.02	9,025.00	92,124.04	24,868.47	8,896.30	22,200.00	62,977.54	13,836.74	1,050.00	**299,646**
	Pjesëmarrja	1,554.00												**1,554**
	Trajnimet	1,980.00												**1,980**
	Donacioni nga GIZ për STIKK Training Academy	1,276.36												**1,276**
TOTAL TË HYRAT		***37,497.00***	***19,965.40***	***24,996.00***	***1,570.02***	***9,025.00***	***92,124.04***	***24,868.47***	***8,896.30***	***22,200.00***	***62,977.54***	***13,836.74***	***1,050.00***	***319,007***

Shpenzimet

Gjatë periudhës raportuese, shpenzimet e STIKK arritën shumën prej 325,881€ (4.21% më pak krahasuar me 339,595€ në vitin 2013). Disa nga projektet nuk janë mbyllur këtë fundvit, pasi që edhe kontratat por edhe kohëzgjatja është e ndryshme. Pasqyra e shpenzimeve në detaje është e prezantuar ne tabelën në vazhdim:

		STIKK	Athene Prosjektledelse AS				SPARK	EU - FP7	SDC/Helvetas	British Council	Royal Norwegian Embassy	GIZ	HELVETAS Swiss Intercooperation dhe Ipko Foundation	TOTAL
			Growth Programme	ICK	Womminovation	HERD/AEP	MFS II	ICT - KOSEU			National Kosovo IT Strategy	Local Subsidy 2014	Young Coders	
SHPENZIMET														
	Shpenzimet e pagave (kostoja totale)	23,143.93	5,700.00	17,368.45	525.64	9,025.00	38,478.04	10,371.74	2,573.68		10,761.60	1,293.74		119,242
	Shpenzimet për konsulentët						5,900.00				56,668.00			62,568
	Shpenzimet e udhëtimit/transportit	50.00	153.83	63.83			83.10				95.00			446
	Shpenzimet e marketingut													0
	Shpenzimet e materialit të zyrës										59.35			59
	Shpenzimet konsumuese	5,671.41	3,980.47	3,098.50			4,550.73		100.21	281.09	931.16	1,180.00		19,794
	Shpenzimet e karburanteve/derivateve													0
	Shpenzimet postale, DHL													0
	Shpenzimet e telefonit													0
	Shpenzimet e internetit													0
	Shpenzimet e printimit													0
	Shpenzimet për paisje të vogla IT	943.81	92.00	94.90			5.22							1,136
	Shpenzimet për paisje të vogla të zyrës													0
	Shpenzimet mbi mirëmbajtjen	300.00	480.00											780
	Shpenzimet ndaj qirasë													0
	Shpenzimet bankare													0
	Shpenzimet e zhvlerësimit	1,237.69												1,238
	Shpenzimet e përfaqësimit													0
	Shpenzimet e sigurimit													0
	Shpenzimet e trajnimeve të stafit													0
	Shpenzimet tjera	850.00	306.38	161.90							200.00			1,518
	Shpenzimet e bord-it dhe kuvendit	53.28	1,421.58				285.26							1,760
	Shpenzimet e transportit ndërkombëtar	2,372.00	1,244.81	3,790.21			3,569.15	5,752.56		137.00		738.00		17,604
	Shpenzimet e trajnimeve në kuadër të programeve	515.07	37.28	11.00	1,044.38		26,015.39			17,160.00	411.60			45,195
	Shpenzimet e konferencave	23.95	1,608.00	222.89			12,105.50	288.38	6,222.41		22.83	6,000.00		26,494
	Shpenzimet në kuadër të programeve	1,565.00	4,541.05				1,131.65			4,449.70	88.00	4,625.00	1,241.03	17,641
	Shpenzimet e takimeve B2B	2,802.35	400.00	184.32				6,847.76		172.21				10,407
	Kthimi i mjeteve													0
TOTAL SHPENZIMET		*39,528.49*	*19,965.40*	*24,996.00*	*1,570.02*	*9,025.00*	*92,124.04*	*23,260.44*	*8,896.30*	*22,200.00*	*69,237.54*	*13,836.74*	*1,241.03*	*325,881*
	Rezultati:	-2,031.49	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	1,608.03	0.00	0.00	-6,260.00	0.00	-191.03	-6,874
														0
	Rezultati final më 31/12/2014	*-2,031.49*	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*1,608.03*	*0.00*	*0.00*	*-6,260.00*	*0.00*	*-191.03*	*-6,874*
		0.00	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*	*0.00*			*0.00*			*0*
Gjendja në bank më 31/12/2014														58,917.84
Gjendja në arkë më 31/12/2014														1,318.19
Totali i mjeteve:														60,236.03

MBLEDHJET E BORDIT

Gjatë vitit 2014 u mbajtën gjithsej gjashtë mbledhje të Bordit të STIKK, katër të rregullta (7 Shkurt, 14 Maj, 24 Korrik dhe 11 Nëntor) dhe dy e jashtëzakonshme (24 Janar dhe 8 Prill).

Me 24 Janar, 2014, në mbledhjen e tridhjetedytë (të jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi rreth përgatitjes së amandamentimit dhe definimit të të gjitha ndryshimeve në Statut të STIKK-ut;
2. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. U miratua rendi i ditës;
2. Bordi aprovoj që ndryshimet e rekomanduara për statut të STIKK të propozohen në Kuvendin e radhës.

Ndryshimet janë të listuara në vazhdim:

I. Ndryshimet e domosdoshme

Neni 1 (2) – Adresa e saktë e Shoqatës

Adresa e Shoqatës është i vetmi nen i cili është ndryshuar nga zyra e OJQ-ve herën e kaluar kur janë propozuar ndryshimet e mëparshme.

Neni 2 (1) – Referenca në numrin e Ligjit për lirinë e asocimit në organizata joqeveritare

Ligji në fjalë është ndryshuar pas mbajtjes së mbledhjes së kuvendit, andaj tani e tutje duhet të i referohemi ligjit aktual.

Neni 4 – Emërtimi i nenit – Qëllimet, aktivitetet dhe parimet e punës

Ne këtë nen duhet ndryshohet termi objektivat e STIKK dhe të shënohet qëllimet e STIKK.

Neni 5.5.2 / 11.2.8. dhe 11.2.9. *Autorizimet për pranimin dhe përjashtimin e anëtarëve i takojnë Kuvendit të anëtarëve. Bordi mund të përgatis propozimet për anëtarësi*

Pas shumë diskutimesh që u bënë rreth këtij neni, z. Vokshi propozoi që anëtarësimet e reja të bëhen nga bordi I STIKK, ndërsa përjashtimi I anëtarëve është vendim që duhet të i takoje Kuvendit të anëtarëve.

Neni 9.4.2. Harmonizimi i procesit të vendimmarrjes me dispozitat mbi ndryshimin e Statutit nga neni 19.1 (*shumica e thjeshtë dhe implikimet për ndryshimet e Statutit sipas vendimit të 2/3*)

Vendimmarrja në kuvend duhet të bëhet me 2/3 e votave e anëtareve me të drejt të plotë votë e që janë prezent në mbledhje.

Neni 10. (dhe dispozitat tjera përkatëse) - Emërtimi i Bordit (*Bordi Ekzekutiv*)

Ne këtë rast duhet ndryshuar emërtimi i bordit nga Bordi Ekzekutiv në Bordi Drejtues.

Neni 10.1.2. ***Zgjedhja dhe shkarkimi i Drejtorit ekzekutiv është kompetencë e padelegueshme e Kuvendit të anëtarëve***

Sa I përket vendimit për zgjedhjen apo shkarkimin e Drejtorit ekzekutiv ky është vendim që duhet marr nga Kuvendi. Propozimet ishin që këtë ta bëjë Bordi Drejtues.

Neni 11.2.8 / 11.2.9 Anëtarësi dhe përjashtimi i anëtarëve të Kuvendit duhet të jetë kompetencë e Kuvendit të Anëtarëve

Ky nen është i ngjashëm me Nenin 5.5.2.

Neni 13.2. Të harmonizohet kjo dispozitë me dispozitat tjera të Statutit (*Aktet nënstatutore miratohet nga organi më I lartë drejtues (Kuvendi).*

Ky nen u propozua të mbetet kështu siç është.

Neni 14.2. **Emërimi dhe shkarkimi i Drejtorit Ekzekutiv nga Kuvendi (*zgjedhja e zyrtarëve në pozita udhëheqëse të OJQ-së është kompetencë që nuk delegohet);***

Ky nen është i ngjashëm me Nenin 10.1.2.

Neni 15. Përfaqësimi ligjor. Të shënohet emri i përfaqësuesit ligjor dhe autorizimet e tij

Pas shumë diskutimesh dhe mospajtimesh në mes të anëtarëve të bordit u vendos që Kuvendit të i propozoheshin dy mundësi dhe të zgjidhnin në mes të:

a) Drejtorit Ekzekutiv dhe;
b) Kryetarit te Bordit Drejtues.

*****Autorizimet ligjore të përfaqësuesit të autorizuar janë:*

- *të përfaqësojë OJQ-në;*
- *të pranojë njoftime dhe hetime zyrtare (shkresat);*
- *të nënshkruar raportet për dorëzim në organet përkatëse;*
- *ka përgjegjësi juridike pranë organeve shtetërore.*

Me 7 Shkurt, 2014, në mbledhjen e tridhjetetretë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetenjëtë (e rregullt) mbajtur më 23 tetor 2013 dhe mbledhja e tridhjetedytë (e jashtëzakonshme) e Bordit të STIKK, mbajtur me 24 janar 2014;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit vjetor te STIKK;
4. Organizimi i Kuvendit të 6-të të STIKK:
   a. Caktimi i lokacionit,
   b. Ndryshimet ne statut,
   c. Votimi dhe përzgjedhja e anëtareve te rinj te Bordit,
   d. Shpërndarja e përgjegjësive anëtarëve te Bordit për mbledhjen e Kuvendit Vjetor;
5. Diskutimi rreth kontratës se Drejtoreshës Ekzekutive;
6. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. U aprovua rendi i ditës;
2. U miratua unanimisht Procesverbalin e mbledhjes se tridhjetenjë dhe tridhjetedy te Bordit te STIKK;
3. U aprovua unanimisht Raporti tre mujor i STIKK;
4. U aprovua unanimisht Raporti vjetor i STIKK;
5. U caktua lokacioni i mbajtjes së Kuvendit të 6-të, i cili do të organizohet në Prishtinë;
6. U vendos që Bordi i STIKK të përgatisë listën e anëtarëve të cilët dëshirojnë të bëhen pjesë e bordit të STIKK;
7. U vendos që të vazhdohet kontrata e Drejtoreshës Ekzekutive deri më Prill, 2016;
8. U pranua dorëheqja e znj. Diturie Hoxha nga bordi drejtues i STIKK.

Sa i përket ndryshimeve në statut të STIKK, aprovimin e listës së anëtarëve të rinj në bord të STIKK, dhe shpërndarjen e përgjegjësive të anëtarëve të bordit, të vendosen në Kuvendin e 6-të që do të organizohet me 17 Prill 2014.

Me 8 Prill, 2014, në mbledhjen e tridhjetekatërtë (të jashtëzakonshme), ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetetretë (e rregullt) mbajtur më 7 shkurt 2014;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
3. Përgatitjet finale për Kuvendin e 6-të të STIKK. Përcaktimi i detyrave për te siguruar pjesëmarrjen sa me te madhe te anëtarëve;
4. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. U miratua rendi i ditës;
2. Bordi aprovoi mysafiret për fjalimet hyrëse ne Kuvend, u vendos gjithashtu qe te përgatitet një dokument me te gjitha informatat rreth ndërrimit te anëtareve si dhe u vendos qe znj. Zana Tabaku te jete përgjegjëse për prezantimin e pakos se re te anëtarësisë.

Me 14 Maj, 2014 në mbledhjen e tridhjetepestë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Mirëseardhje për anëtarët e rinj te Bordit;
2. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetetretë (e rregullt)dhe mbledhja e tridhjetekatërtë (e jashtëzakonshme), te mbajtura më 7 shkurt 2014 dhe 8 prill, 2014;
3. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
4. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. U aprovua rendi i ditës;
2. Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes së tridhjetetretë dhe tridhjetekatërtë të Bordit të STIKK;
3. U aprovua raporti tremujor i STIKK.

Me 24 Korrik, 2014 në mbledhjen e tridhjetegjashtë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetepestë (e rregullt) e mbajtur me 14 maj 2014;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
3. Raportimi mbi ndryshimet ne ICK;
4. Koncepti i ri për Training Academy;
5. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. Miratuan unanimisht Procesverbalin e mbledhjes se tridhjetepestë te Bordit te STIKK;
2. Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK;
3. Te ndryshohet koncepti i Training Academy-së;
4. Miratuan unanimisht vendimin për pjesëmarrjen e dy anëtarëve te bordit z.Brestovci dhe z.Sahiti ne vizitën e punës ne Austri dhe Gjermani.

Me 11 Nëntor, 2014 në mbledhjen e tridhjeteshtatë, ku janë diskutuar çështjet në vijim:

Rendi i ditës:

1. Diskutimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e tridhjetegjashtë (e rregullt) e mbajtur me 24 korrik 2014;
2. Diskutimi dhe aprovimi i raportit tremujor të STIKK;
3. Aprovimi i Marrëveshjes se Bashkëpunimit në mes të STIKK, Shoqatës së gjeodetëve të Kosovës dhe GIZ;
4. Të ndryshme.

Pas diskutimeve, Bordi mori vendimet ne vijim:

1. Aprovohet rendi i ditës;
2. Të caktohet një takim me grupin punues për pakon fiskale dhe të bëhet një plan i veprimit në mënyrë që të përfshihet Oda Ekonomike Amerikane e Kosovës dhe mediat, si dhe të përgatitet pyetësori i cili është në krye të z. Doko sa i përket brengave dhe problemeve te anëtarëve;
3. Aprovohet raporti 3 mujor i STIKK;
4. Aprovohet Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje.

PËRMBYLLJE

Viti 2014 karakterizohet me disa suksese të mëdha, duke filluar nga organizimi i serishëm i suksesshëm i konferencës rajonale KosICT, hapjen e mundësive te reja për eksport te shërbimeve ne fushën e TIK, organizimi i Business-to-Business aktiviteteve, ofrimi i trajnimeve cilësore përmes STIKK Training Academy, si dhe rritjes se rëndësisë se STIKK karshi partnereve ndërkombëtar dhe Qeverisë së Kosovës.

Në periudhën e ardhshme njëvjeçare, STIKK do të vazhdojë të angazhohet rreth krijimit të një ambienti më të favorshëm për kompanitë anëtare, ndërsa theks i posaçëm do të i jepet ofrimit të mundësive për eksport të produkteve dhe shërbimeve si edhe çështjes së avancimit të edukimit dhe trajnimit të kuadrove profesionale për tregun e Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.

Prishtinë,

Janar, 2015

STIKK